



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI

Nr. 404/Prot.

Tiranë, më 3.6.2019

Lënda: Njoftim për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë së tokës bujqësore Nr.3105 prot, Nr.834 Rep, Nr.281 Kol, datë 13.04.2017

Z.Shkëlqim KESHI, ADMINISTRATOR


“Projekti MOLLA DIBËR” shpk

Adresa: Rruga “Themistokli Germenji”, mbi Restorantin Kinez, kati i dytë,
Njësia Bashkiake Nr.5

Tiranë

Me Kontratën Nr.3105 prot, Nr.834 Rep, Nr.281 Kol, datë 13.04.2017 Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me cilësinë e Autoritetit Qiradhënës, i ka dhënë me qira shoqërisë suaj tokën bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe 31.14 ha, të ndodhur në Zonën Kadastrale 3811, e përbërë prej ngastrës me numër pasurie 2/17, fshati Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, bashkia Dibër, Qarku Dibër, për kultivimin, prodhimin, tregtimin dhe përpunimin e mollës, për një afat prej 90 vjet.

Nga studimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se kjo sipërfaqe nuk është dorëzuar me procesverbal. Nga monitorimi i kryer në terren nga Struktura Përgjegjëse për monitorimin rezultoi se nuk janë kryer investime nga shoqëria juaj, me pretendimin se fermerë të zonës ju kanë penguar shfrytëzimin e kësaj parcele. Shoqëria juaj përveç nënshkrimit të kontratës së qirasë nuk ka kryer asnjë veprim tjetër në përmbushje të detyrimeve kontraktore, konkretisht : pagesën e qirasë vjetore për vitin 2018 si dhe parapagimin, ngurtësimin e vlerës së garancisë së investimeve, nuk ka paraqitur informacionet periodike në lidhje me përmbushjen e kontratës së qirasë, nuk është paraqitur për të marrë në dorëzim tokën apo për të aplikuar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Dibër për regjistrimin e kontratës së qirasë. Nga shoqëria juaj nuk ka patur asnjë komunikim shkresor ku të jenë njoftuar problemet që ju mund të keni patur në lidhje me këtë kontratë qiraje.



Nga verifikimi online në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar, rezulton se subjekti “Projekti Molla Dibër” shpk, NUIS L61724009C më datë 21.12.2017, ka depozitur Vendimin e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë, në të cilin është vendosur *pushimi i përkohshëm i aktivitetit, pa afat*. Me këtë vendim shoqëria juaj ka humbur personalitetin juridik dhe kishte detyrimin të njoftojë qiradhënësin, kundrejt të cilit ka detyrime kontraktore që rrjedhin nga kontrata e qirasë.

Me pezullimin e statusit juridik të shoqërisë “Projekti Molla Dibër” shpk, ju nuk mund të ushtroni asnjë lloj veprimtarie tregtare në funksion të kontratës së qirasë të lidhur me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pezullimi i aktivitetit të shoqërisë suaj, rrjedhimisht është shkak dhe për mospërbushjen e detyrimeve kontraktore nga ana e juaj.

Nisur nga sa më sipër, duke qenë se kontrata nuk i ka filluar efektet e saj për shkak të sa kemi shpjeguar këtu më sipër, si edhe duke qenë se shoqëria juaj (qiramarrësi) si person juridik ka pezulluar aktivitetin e saj që prej datës 21.12.2017, ju njoftojmë se Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e konsideron Kontratën e Qirasë Nr.3105 prot, Nr.834 Rep, Nr.281 Kol, datë 13.04.2017, të zgjidhur që prej datës së njoftimit sipas kësaj shkrese.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

